



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 22.06.2026

Lënda: Njoftim për shpallje konkursi për 2 (dy) pozicione pune në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE

K Ë T U

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, gërma d); në Rregulloren e UST-së, neni 41 “*Personeli Administrativ*”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “*Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës*”, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 51, datë 14.11.2022 “*Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë*” të ndryshuar me Vendim të Bordit të Administrimit me nr. 67, datë 12.12.2025 “*Për një ndryshim të Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 51, datë 14.11.2022 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë” si dhe në shkresën e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse me nr. 1237 prot, datë 12.06.2026 “Kërkesë për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante të Sektorit të Prokurimeve”, shpall kriteret për 2(dy) vende pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës, “Specialist/e” në Sektorin e Prokurimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.*

I. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 2 (dy) pozicione pune si “**Specialist/e**” në Sektorin e Prokurimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, janë si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

1. Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit parë ose të dytë, (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
3. Të ketë përvojë të mëparshme pune;
4. Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
5. Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi.
6. Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta

1. Të ketë diplomë të nivelit “Bachelor” dhe “Master Profesional” ose DIND në shkenca ekonomike/juridike/inxhinierike.
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.

3. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Vlerësimi i intervistës për kandidatët që konkurojnë për këto vende pune është:

1. Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.
2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
 - a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje jetëshkrimi;
3. Diplomë e shkollës së lartë dhe certifikatë notash e noterizuar.
 - Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 - Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
4. Diploma e certifikata të ndryshme të kualifikimeve të noterizuara.
5. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj të noterizuar.
6. Dëshmi penaliteti/formulare vetedeklarimi .
7. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga institucionet ku ka punuar.
8. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm.
9. Certifikatë e gjendjes familjare .
10. Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për punë.

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

IV . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 2 (dy) javë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit në faqen Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Drejtoria, emri, mbiemri, adresa e konkurentit.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.
- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE E ARKIV/PROTOKOLLIT